



Data	
Nr. Prot	

RELACION

VENDIMI

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA BASHKIMI POPULLOR I PENSIONISTËVE SHQIPTAR” PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399 datë 5.12.2024 ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

“Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Selami Jenishehri, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 25.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Bashkimi Popullor i

Pensionistëve Shqiptar”, me initiale “PBPPSH”, me Kryetar Z. Selami Jenishehri, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.

- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02)
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03)

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar” me shkronja nistore “PBPPSH”, me adresë Rruga "Muhamet Gjollesha", Godina "Ish Shtëpia botuese 8 Nëntori", Kt. 3, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Selami Jenishehri, me adresë Rruga "Muhamet Gjollesha", Godina "Ish Shtëpia botuese 8 Nëntori", Kt. 3, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Z. Artur Furriku, me adresë Rruga "Komuna Parisit", Nd. 10, H. 20, Ap. 4, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjes për komunikim me KQZ-në është Z. Selami Jenishehri, me adresë Rruga "Muhamet Gjollesha", Godina "Ish Shtëpia botuese 8 Nëntori", Kt. 3, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Licela VELIU	-Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit
---------------------	---

Pavlina DOÇAJ	-Drejtorja e Ligjshmërisë
----------------------	---------------------------

Majlinda ÇELMETA	-Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)
-------------------------	---